

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti për Krime të Rënda, trupi gjykues i përbërë nga gjyqtari Skender Çoçaj si kryetar i trupit gjykues, gjyqtarët Kymete Kicaj dhe Gani Kastrati si anëtarë të trupit gjykues, me procesmbajtësen Birsën Kume- sekretare juridike pranë kësaj gjykate, duke vendosur, në lëndën penale, kundër të akuzuarit D. D., nga Vushtria, për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje, të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273, par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Shtetit me emërtimin, PP.nr. 44/15 të datës 05.05.2015, në shqyrtimin gjyqësor, në prezencën e Prokurorit të Shtetit, Mehdi Sefa, të akuzuarit, dhe mbrojtësit të tij Av. A. H. nga Prishtina me datë 18.04.2016, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. D., nga i ati R. dhe e ëma F., e vajzërisë V., data e lindjes ... në Prizren, me banim në Vushtri, i pa martuar, ka të kryer shkollën mesme, punëtorë, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datë 08.03.2015 rreth orës 12:45 min, në pikën kufitare në Vërmicë, pa autorizim transporton substanca psikotropike të llojit marihuanë e cila është shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e policisë kufitare së bashku me oficer të doganës, të automjetit 'Ford Fokus', ngjyrë hiri me targa xx-xxx-xx, e cila drejtohej nga D. D. dhe me pasagjer F. M., janë gjetur katër qese të substancës psikotropike të llojit marihuanë, në sasi prej 997.12 gr. e cila është identifikuar si pronë e të akuzuarve.

Në këtë mënyrë, në bashkëkryerje ka kryer veprën penale, të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273, par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, andaj

Gjykata në kuptim të dispozitave së lartshënuara dhe neneve: 4, 7, 41, 42, 43, 45, 46, 73 dhe nenit 273 paragr.2 lidhur me nenin 31 të KP-së të akuzuarin ei:

G J Y K O N

-Me dënim me gjobë në lartësinë prej 500 (pesëqind) Euro të cilën shumë i akuzuari është i obliguar ta paguajë në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në rast se i akuzuari nuk mundet ose nuk dëshiron që ta paguajë gjobën, atëherë dënimin me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 euro të gjobës do të llogaritet një ditë burgim, si dhe,

-Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vitesh , në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 08.03.2015 e deri me 03.07.2015.

Në kuptim të nenit 273 paragrafi 5 konfiskohet substanca narkotike e llojit marihuanë në sasi prej 997.12 gram.

I akuzuari obligohet që t'i paguaj shpenzimet procedurale si dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 150 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar aktakuzën PP.nr. 44/15, të datës 05.05.2015, kundër të akuzuarit D. D., për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje, të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge nga neni 273, par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së. Prokurori i çështjes në fjalën e tij përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë aktakuzës, ka deklaruar se duke u bazuar në rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, nga provat e administruara, si dhe nga provat që gjenden në shkresat e lëndës, me pa mëdyshje është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve, në këtë çështje penale, janë formuar elementet e veprës penale nga neni 273, par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, andaj i ka propozuar gjykatës që të njëjtët t'i shpall fajtor dhe t'i dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit Av. A. H. gjatë shqyrtimit kryesorë në fjalën e tij përfundimtare të cilën e ka përgatitur dhe dorëzuar me shkrim pranë së cilës ka ngelur edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor duke shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje janë administruar një mori provash të propozuara nga prokurori i shtetit gjithashtu edhe të propozuara nga mbrojtja duke shtuar se provat e propozuara nga prokuroria i konsideron si jo relevante pasi që prokuroria edhe në dispozitivin e aktakuzës por edhe në fjalën përfundimtare i imagjinojnë veprimet e të mbrojturit tim nga se nuk është administruar asnjë provë për veprimet konkrete që formojnë figurën e veprës penale, nga se nga e din prokuroria se ku, kur, për sa është blerë narkotiku, nga kush është blerë ky narkotikë, kush e ka vendosur në veturë narkotikun e në këtë mënyrë e gjithë veprimtaria e kundërligjshme duke shtuar se i akuzuari nuk ka qenë në posedim të narkotikut i cili ishte i fshehur në pjesë të veturës ku ai nuk ka mund ta shoh në shikim të thjeshtë. Nuk ekziston asnjë provë e vetme me të cilën argumentohet që i akuzuari ta ketë ditur se në veturë gjendet narkotikë, prandaj në cilën provë është vërtetuar që D. D. e ka vendosur narkotikun apo se e ka ditur që gjendet aty, prandaj gjykata nuk mund të vërtetojë rrethanat e spekuluar nga faktet e pavërtetuara e që në kontekst të parimit "IN DUBIO PRO REO" secila rrethanë e pasqaruar mirë tek e cila ekziston ndonjë dyshim duhet të konsiderohet në favor të akuzuarit. I bashkëpandehuri F. M. e ka sqaruar mjaftë mirë të gjitha rrethanat e kësaj çështje duke i sqaruar të gjitha veprimet e kundërligjshme të tija se i njëjti të gjitha këto veprime i ka ndërmarrë pa prezencën dhe pa dijeninë e të akuzuarit D. D. Në vazhdim ka potencuar se udhëzimet e Gjykatës së Apelit duhet të merren parasysh me rastin e vendosjes në rigjykim. Për sa i përket analizimit të provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor në raport me të akuzuarin D. D. janë jo relevante nga se shumica nga këto vërtetonin fajësinë e të bashkëpandehurit F. M. dhe kishin të bënin me të e jo me të akuzuarin D. Sa i përket deklaratës së dëshmitarit Z. I. kjo deklaratë nuk ka kurrfarë relevance nga se është krejtësisht periferike nga se huazimi i veturës nuk është veprim i kundërligjshëm për më tepër kjo provë vetëm sa e shfaqëson të akuzuarin nga se kjo dëshmitare ka deklaruar se edhe më herët ia kishte dhënë në huazim të njëjtën veturë, gjithashtu rrethanë shumë e rëndësishme është se e demanton edhe vet prokurori nga se vetura në fjalë i është kthyer kësaj dëshmitare pra vetura nuk është mjet i kryerjes së veprës penale. Raporti i ekspertizës së Agjencionit për Forenzikë për ekzaminimin e narkotikut këtë provë e konsideron si jo relevante në raport me të

akuzuarin D. pasi që i bashkëpandehuri tjetër ishte në posedim dhe pronësi të tij. CD me video incizim nuk argumenton asgjë të rëndësishme pasi që përmban vetëm incizimet e policisë gjatë kontrollimit të veturës dhe gjeti se narkotikun të fshehur për të cilin i mbrojturi im nuk kishte njohuri për të cilin narkotikë i bashkëpandehuri tjetër e ka pranuar se është i tij.

Sa i përket vërtetimin për marrjen e përkohshme të sendeve ka shtuar se asnjë herë nuk ka ndodhur që të përpilohet një vërtetim për marrje të përkohshme të sendeve në raport me më shumë se një person nga se përgjegjësia për sendin është individuale sikurse është pronësia apo posedimi, i akuzuari D. e ka pranuar se në këtë vërtetim nga ai janë marr vetëm sendet në rubrikën D 6 dhe D 10 të cilat sende nuk janë të kundërligjshme ndërsa sendet tjera ka pranuar se janë marr nga F. M., në këtë mënyrë duhet të vijë në shprehje parimi “ IN DUBIO PRO REO” për shkak se nuk është specifikuar kuartë se narkotikun janë marr nga D. D. dhe mos sqarimi i kësaj çështje duhet të shkon në favor të akuzuarit. Sa i përket raporteve të vendkalimeve kufitare këto janë jorelevante nga se nuk është kontestuese se i akuzuari ka kaluar nëpër vendkalimin kufitarë, nuk është kontestuese që në atë veturë të jenë gjetur narkotikë, mirëpo kjo nuk mjafton që i akuzuari të shpallet fajtorë kur mirret për bazë deklaratat e të bashkëpandehurit tjetër i cili ka pranuar veprimet e kundërligjshme dhe e ka shfajësuar të mbrojturin tim e aq më pak kur me këtë provë përmendet vetura e cila është kthyer dhe nuk është parë si relevante në kontekst të mjetit me të cilin qenka kryer vepra penale. Sa i përket autorizimit i njëjti nuk ka kurrfarë relevance në drejtim të veprës penale madje demanton prokurorin nga se autorizimi është hartuar me datë 07.03.2015 në ditën kur është kontrolluar prindi i të mbrojturit tim atëherë kur është paraqitur nevoja për veturë, pra nuk ka të bëjë me marrje të veturës më herët se ditën kur është paraqitur nevoja që do të thotë se nuk ka ekzistuar ndonjë plan konkret për të shkuar në Shqipëri por e tëra paraqitet aty për aty kur i bashkëpandehuri tjetër takohet në spital dhe i propozon që të shkojë për në Shqipëri që është një shkuarje spontane.

Në vazhdim ka deklaruar se sipas raportit mjekësor të QKMF Vushtri të datës 07.03.2015 argumentohet huazimi i veturës por meqenëse i akuzuari nuk kishte mundësi financiare të udhëtojë për trajtim jashtë vendit u shfrytëzua për një udhëtim tjetër e çka është me rëndësi se kundërshtohet teoria e prokurorit se kinse autorizimi është marr për qëllim të shkuarjes për në Shqipëri. Në fund të fjalës së tij përfundimtare mbrojtësi i të akuzuarit ka kërkuar që mbrojtja e të akuzuarit D. D. të merret si e sinqertë pasi që është një person i cili nuk është dënuar më herët ndërsa i bashkëpandehuri tjetër F. M. ka qenë i dënuar më herët e që tregon se i njëjti e ka kryer veprën penale vet e jo me të akuzuarin D. D., gjithashtu nuk mund të anashkalohet edhe fakti se kemi një përputhje totale të deklaratave të tyre e që tregon se F. M. është kryes i veprës penale i vetëm pa dijeninë e mbrojturit tim për më tepër i mbrojturi im nuk ka veturë personale për këtë arsye ka huazuar veturën dhe se ngasja e kësaj veture në vendkalimin kufitar ka qenë e domosdoshme pasi që i mbrojturi im ishte i autorizuar për ta drejtuar veturën ndërsa i bashkëpandehuri tjetër nuk kishte leje të vozitjes e kjo rrethanë nuk mund të merret e kundërligjshme. Në përfundim ka propozuar që ndaj të akuzuarit D. D. të merret aktgjykim lirues.

I akuzuari D. D., gjatë seancës së shqyrtimit kryesor, nuk e kanë pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë me akuzë.

Gjykata, ka nxjerr të gjitha provat e domosdoshme dhe pas vlerësimit të secilës prove veç e veç dhe të gjitha provave në tërësi, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D. D. me datë 08.03.2015 rreth orës 12:45 min, në pikën kufitare në Vërmicë, pa autorizim transporton substanca psikotropike të llojit marihuanë e cila është shpallur me ligj si narkotik, me qëllim të shpërndarjes dhe shitjes, në atë mënyrë që gjatë kontrollimit nga ana e policisë kufitare së bashku me oficer të doganës, të automjetit ‘Ford Fokus’, ngjyrë hiri me targa xx-xxx-xx, e cila drejtohej nga D. D. dhe me pasagjer F. M., janë gjetur katër

qese të substancës psikotropike të llojit marihuanë, në sasi prej 997.12 gr. e cila është identifikuar si pronë e të akuzuarve.

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në këtë çështje penale, ka lexuar me pajtimin e palëve dëshminë e dëshmitares Z. I. dhe ka nxjerrë provat tjera materiale dhe atë: Raporti i ekspertizës të Agjencionit për Forenzikë me nr. AKF/2015-1157-2015-975; Fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr. 2015-YËV-015 i dt.08.03.2015; CD-DVD me nr. të rastit 2015-YËV-015, ka lexuar vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, ka lexuar autorizimin e dhënë nga Z. I. për të akuzuarin D. D., ka lexuar Raportin për kontrollin kufitar aneksi A, B dhe C të datës 13.03.2015, ka lexuar udhëzimin për konsultim për prindin e të akuzuarit D. D. lëshuar nga QKMF Vushtri.

Dëshmitarja Z. I. deklarata e së cilës është lexuar në shqyrtimin kryesorë ka deklaruar se të akuzuarin D. D. e njeh që 6-7 vite dhe i njëjti me datë 07.03.2015 ia ka kërkuar për huazim automjetin "Ford Focus", për shkaqe familjare sepse e ka pas një anëtarë të familjes të sëmurë dhe ka pasur nevojë ta shoqërojë tek mjeku. Më tej ka shtuar se nuk ka qenë e njoftuar se D. D., ka shkuar në Shqipëri, të njëjtit ia ka dhënë autorizimin për vozitjen e automjetit brenda dhe jashtë vendit. Në vazhdim ka shtuar se autorizimin e kishin përpiluar te avokati pasi që atë ditë ishte ditë e shtunë e noteri nuk punonte, ndërsa F. M. nuk e njeh mirë sepse e ka takuar vetëm 2 apo 3 herë, me automjetin e saj janë nisur për në Shqipëri, ndërsa për atë se në automjetin e saj është bartur marihuana është njoftuar të nesërmen më 08.03.2015, përmes avokatit A. H.

Gjykata në tërësi ia fali besimin deklaratës së dëshmitares Z. I. ngase deklarata e tillë ka mbështetje në të gjitha provat e administruara gjatë shqyrtimit kryesor.

Nga raporti i ekspertizës të Agjencisë së Kosovës për forenzikë me nr.AKF/2015-1157/2015-975 i datës 23.04.2015 gjykata ka vërtetuar se sasia e narkotikut e gjetur ditën kritike është në peshë të përgjithshme prej 997.12 gr, dhe përbërja kimike e saj është kanabis (marihuanë) që përmbanë tetrahidrokanabinal.

Nga fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes shihet i akuzuari D. D. (me të dënuarin F. M.) dhe substanca narkotike e llojit marihuanë e cila iu është gjetur në veturën Ford Fokus e futur në katër qese plastike.

Nga raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me nr.2015- YWV-015 të datës 08.03.2015 vërtetohet se me datën 08.03.2015 policët e teknikës kriminalistike kanë shkuar në vendin e ngjarjes në pikën kufitare në Vermicë ku janë informuar se oficerët doganor gjatë kontrollit të automjetit "Ford focus" ngjyrë të hirit metalike me targa RKS-xx-xxx-xx kishin gjetur 4 qese najloni ngjyrë të zezë me materje të dyshuar të llojit marihuanë me këtë rast është bërë fotografimi i pjesës së jashtme të automjetit në fjalë dhe video incizimi i të akuzuarve F. M. dhe D. D. të cilët kanë qenë duke drejtuar automjetin e lartpërmendur.

Nga CD-DVD me nr. të rastit 2015 -YWV- 015 shihet automjeti " Ford focus" ngjyrë të hirit metalike me targa RKS-xx-xxx-xx në të cilin janë gjetur 4 qese najloni ngjyrë të zezë me materje të dyshuar të llojit marihuanë si dhe të akuzuarit F. M. dhe D. D. të cilët kanë qenë duke drejtuar këtë automjet.

Nga udhëzimi për Konsultim Nr.34059 të lëshuar me datë 07.03.2015 të lëshuar nga QKMF Vushtri për R. D. babi i të akuzuarit D. D., vërtetohet se R. D. me datë 07.03.2015 ka kryer vizitë mjekësore në QKMF Vushtri dhe i njëjti është udhëzuar për kontrolle për në QKUK Prishtinë.

Nga vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve vërtetohet se zyrtarët policor nga njësia rajonale e hetimit të trafikimit me narkotikë në Prizren me datë 08.03.2015 nga D. D. dhe F. M. kanë konfiskuar përkohësisht mes tjerash katër qese plastike me substanca të dyshuar për narkotikë vërtetim ky i nënshkruar edhe nga i akuzuari D. D.

Nga autorizimi me shkrim i dhënë nga Z. I. me datë 07.03.2015 vërtetohet se autorizim dhënësja Z. I. i ka dhënë autorizim të akuzuarit D. D. për të drejtuar automjetin Ford Fokus me targa të regjistrimit xx-xxx-xx në Kosovë dhe në shtetet e botës së jashtme.

Nga Raporti për kontroll kufitar aneksi A, B dhe C të datës 13.03.2015 është vërtetuar se me datë 08.03.2015 koha e hyrjes 12:45 në pikën kufitare Vërmicë ka hyrë D. D. datëlindja 15.02.1982 automjeti me targa të regjistrimit xx-xxx-xx me një pasagjerë ku gjatë kontrollit të makinës "Ford Focus" ku si vozitës ishte D. D. e pasagjerë F. M. është zbuluar një sasi e substancave narkotike.

I akuzuari D. D., gjatë shqyrtimit gjyqësor, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se është e vërtetë se Z. I. ia ka kërkuar automjetin për shkaqe familjare pasi që babain e ka pasur të sëmurë dhe të shtrirë në spital, pasi ka shkuar në spital me vizitu babain, aty e ka takuar F. M. i cili iu ka lutur të shkojnë deri në Shqipëri për të takuar të dashurën, dhe atë ditë janë nisur për në Durrës, pasi që kanë shkuar atje F. ia ka kërkuar automjetin për tu takuar me të dashurën, pastaj është kthyer rreth orës 22:30, atë natë kanë fjetur në veturë dhe të nesërmen në mëngjes F. ia ka kërkuar sërish automjetin për të shkuar mu përshëndet me të dashurën, është vonuar afër 2 orë dhe pastaj është kthyer dhe janë nisur për Kosovë, kur kanë mbërrirë në pikën kufitare i kanë ndaluar policia dhe gjatë kontrollit në automjet janë gjetur substancat narkotike. Ka theksuar se nuk ka pasur dijeni për drogën që është gjetur në automjet, e as që djali i hallës së tij është konsumues i drogës.

Sa i përket mbrojtjes së dhënë nga i akuzuari D. D. gjykata konstatoi se edhe për kundër faktit se i akuzuari nuk e ka pranuar fajësinë i njëjti në realitet me rastin e paraqitjes së mbrojtjes së tij i ka pranuar veprimet kryesë, i njëjti e pohon se ka marr një autorizim nga dëshmitarja Z. I. për veturën e saj "Ford focus", i akuzuari e pohon se me këtë veturë së bashku me të akuzuarin tjetër F. M. të cilin gjykata e ka shpallur fajtorë, me datën 07.03.2015 po të njëjtën ditë kur e kish marr autorizimin shkojnë së bashku në Shqipëri, i akuzuari e pohon se ishte ai vet personalisht që e ka vozitur këtë veturë, i akuzuari e pohon se me datën 08.03.2015, ishte ai vet duke drejtuar këtë veturë kur ndalen në pikën kufitare në Vërmicë dhe gjatë kontrollit të veturës i janë gjetur narkotikët objekt i kësaj akuze, i akuzuari po ashtu e pranon se edhe ai vet personalisht e ka nënshkruar vërtetimin mbi sendet e marra në mes të cilëve edhe narkotikun edhe pse gjoja nuk e ka ditur se çka po nënshkruan. I akuzuari e mohon se autorizimin dhe veturën e kishte marrë për të shkuar në Shqipëri se gjoja këtë autorizim e ka marr që ta dërgojë prindin e tij në shërim jashtë vendit edhe përkundër faktit se nga udhëzimi mjekësor i QKMF Vushtrri babai i të akuzuarit është udhëzuar për kontroll në QKUK në Prishtinë e jo jashtë vendit, ndërsa nga ana tjetër i njëjti deklaron se atë ditë ka shkuar në Shqipëri pasi që nuk kishte mjete financiare për ta dërguar babain e tij për shërim jashtë vendit, e që gjykata në këto rrethana nuk ia fali fare besimin pasi që i akuzuari në njërin anë deklaron se ka marr një autorizim për të udhëtuar jashtë vendit për shërim ndërsa nga ana tjetër deklaron se nuk ka pasur mjete financiare kurse po të njëjtën ditë vendos dhe shkon në Shqipëri e që për gjykatën është jo reale dhe e pavërtetë marrja e një autorizimi dhe huazimi i veturës duke e ditur se nuk ka mjete për ta dërguar prindin në shërim, ndërsa nga ana tjetër edhe përkundër faktit se nuk paska mjete për të dërguar babain e tij për shërim i njëjti duke e ditur gjendjen e babit të tij shkon në Shqipëri me F. vetëm për të takuar femrën e tij, e që kjo pjesë e mbrojtjes së tij është në tërësi e dhënë me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Nga të gjitha provat e administruara, e gjithashtu pjesërisht edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit gjykata konstatoi se në rastin konkret nuk është kontestuese se i akuzuari D. D. me datën

07.03.2015 merr autorizim nga dëshmitarja Z. I. për vozitjen e veturës Ford Fokus dhe me këtë veturë së bashku me F. M. nisen dhe shkojnë në Shqipëri ku edhe furnizohen me narkotik, gjithashtu është jokontestuese fakti se të nesërmen me datë 08.03.2015 në pikën kufitare në Vermicë derisa ishte duke drejtuar veturën është ndalur nga policia e Kosovës dhe pas kontrollit të kryer nga ana e oficerit doganor në automjet të llojit “Ford Focus” janë gjetur 4 qese të substancave psikotropike të llojit marihuanë në sasi prej 997.12 gram, fakt ky që është vërtetuar gjithashtu nga të gjitha provat materiale dhe vet mbrojtja e të akuzuarit. Gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka marrë autorizimin dhe veturën për të shkuar në Shqipëri e jo që të dërgojë prindin e tij në shërim jashtë vendit ngase sipas udhëzimit mjekësor i QKMF Vushtri babai i të akuzuarit është udhëzuar për kontroll në QKUK në Prishtinë e jo jashtë vendit pra fare nuk ka pasë nevojë që të shkojë në kontroll jashtë vendit, i akuzuari është mbrojtur se ka shkuar në Shqipëri pasi që nuk kishte mjete financiare për të dërguar babin e tij për shërim jashtë vendit, e po të njëjtin ditë vendos dhe shkon në Shqipëri duke ditur se nuk ka mjete për të dërguar prindin në shërim ndërsa nga ana tjetër edhe përkundër faktit se nuk paska pasur mjete për të dërguar babain e tij për shërim i njëjti duke e ditur gjendjen e babit të tij shkon në Shqipëri me F. vetëm për të takuar një femër. Në këto rrethana të vërtetuara në tërësi për gjykatën është jokontestuese dhe në tërësi e vërtetuar se D. D. me datë 07.03.2015 huazon automjetin nga Z. I. merr autorizimin prej saj dhe së bashku me F. M. nisen dhe shkojnë në Shqipëri ku furnizohen me lëndë narkotike të cilën e fshehin në automjetin “Ford focus” përkatësisht në kapakun e bagazhit dhe ulësen e prapme të këtij automjeti e të cilët zihen në pikën kufitare në Vermicë, gjendja kjo faktike e vërtetuar në mënyrë të plotë nga të gjitha provat e administruara.

Gjykata nga të cekurat më lartë, padyshim ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit D. D., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, të blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së paautorizuar të narkotikëve, substancave psikotropike dhe analoge, në bashkëkryerje nga neni 273, par.2 lidhur me nenin 31 të KPK-së, prandaj edhe të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në neni 64 të KPK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, gjendjen e dobët ekonomike, se është mbajtës i vetëm i familjes, deri më tani nuk ka ardhur asnjëherë ndesh me Ligjin, në gjykim kanë pasur qëndrim korrekt, kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese, gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPK-së dhe ky dënim i tillë, i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 451, par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN,
P.nr.248/2015, me datë 18.04.2016**

**Procesmbajtësja
Birsen Kume**

**Kryetari i Trupit Gjykuës
Skender Çoçaj**

KËSHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, ndaj këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.